



Zef Noka

JOACHIM VADIAN

**EVROPA JUGLINDORE DHE
SHQIPTARËT**

ZEF NOKA

**JOACHIM VADIAN
EVROPA JUGLINDORE DHE
SHQIPTARËT**

albanisches
institut

St. Gallen, 2025

ZEF NOKA

**JOACHIM VADIAN- EVROPA
JUGLINDORE DHE SHQIPTARËT**

Albanisches Institut
www.albanisches-institut.ch
St. Gallen, 2025

PËRMBAJTJA

Abstrakt	7
Parahyrje	9
Monumenti i Vadian.....	16
Jeta dhe vepra e Vadianit	17
Trashëgimia e Vadianit	20
Epitome trium terrae partium	22
Evropa Juglindore në Epitome	29
a) <i>Moesia Superior (Mezia e Epërme)</i>	32
b) <i>Moesia Inferior (Mezia e Poshtme)</i>	34
c) <i>Thracia (Trakia)</i>	36
d) <i>Macedonia (Magedonia)</i>	44
e) <i>Epirus (Epiri)</i>	51
f) <i>Dalmatia</i>	53
g) <i>Illyris, Liburnia, Istria</i>	57
Përfundim	60
Summary	63
1. Shtojcë.....	67

Abstrakt

Joachim Vadian, në të vërtetë Joachim von Watt, lindi më 29 nëntor 1484 në St. Gallen, Zvicër, dhe ndërroi jetë më 6 prill 1551. Ai ishte një shkencëtar i shquar, humanist, mjek dhe reformator i kohës së Rilindjes (renesancës). Joachim Vadian ka studiuar në Vjenë dhe ka qenë për një kohë edhe profesor. Në Vjenë, ai jo vetëm që zhvilloi interesin për mjekësinë, por edhe për shkencat humaniste. Universiteti i Vjenës ishte një qendër e rëndësishme për studimet humaniste në kohën e tij (fillim-mes të shekullit XVI), dhe Vadian përfitoi nga ky mjedis. Këto përvoja formuan zhvillimin intelektual të Vadianit dhe kontribuan në karrierën e tij më vonë si shkencëtar, mjek, humanist dhe reformator. Si një humanist, Vadian ishte një mbrojtës i arsimit klasik dhe ka kontribuar në shpërndarjen e ideve humaniste në qytetin e tij të lindjes, St. Gallen, Zvicër. Ai u zgjodh kryebashkiak i St. Gallen në vitin 1526 dhe

luahti një rol të rëndësishëm në përhapjen e Reformës protestante në këtë rajon. Joachim Vadian gjithashtu ka vepruar si shkrimtar, duke shkruar poezi, vepra historike dhe shkrime mjekësore. Vadian ka lënë një trashëgimi të pazëvendësueshme nga koha e tij. Në kuadër të kësaj trashëgimie kemi edhe veprën e tij të rëndësishme “*Epitome trium terrae partium*” që flet për gjeografinë biblike, për Evropën Juglindore dhe vendbanimet shqiptare.

Fjalë kyçe:

Marrëdhëniet shqiptare-zvicerane, Epitome trium terrae partium, Joachim Vadian, Gjeografia Biblike, Moesia Superior (Mezia e Epërme), Moesia Inferior (Mezia e Poshtme), Mecedonia (Magedonia) Epirus (Epiri), Dardania, Iliria, Buthrotum, Acroceraunia (Malet Ceraunike, Mali i Kanalit), Elyma (Vlorë), Apolonia, Dyrrachium (Durrësi) dhe Scardona (Shkodër), Shën Pali dhe përhapja e Krishterimit (Romakëve 15).

Parahyrje

Në fund të shekullit të 15-të, pelegrinët evropianë udhëtonin në vendet e shenjta si Jerusalemi, Roma dhe Santiago de Compostela. Në këto pelegrinazhe morën pjesë edhe qytetarë të begatë nga qytetet gjermane dhe zvicerane, veçanërisht në Tokën e Shenjtë të Jerusalemit. Disa prej këtyre pelegrinëve shkruanin raporte pelegrinazhi që përmendnin edhe Shqipërinë. Ata udhëtuan me anije përgjatë bregdetit shqiptar dhe raportuan për këtë. Një tregim i tillë vjen nga Hans Bernard von Eptingen, një fisnik gjermano-zviceran që udhëtoi në vitin 1460 me anijen e Dukës Otto II von *Pfalz-Mosbach*.¹ Në raportin e tij ai përshkruan përshtypjet e tij gjatë lundrimit përgjatë gjirit të Vlorës, ku tregon për malet, një ujëvarë dhe flakët që digjeshin në majë të një mali.² Një tjetër pelegrin, *Felix Fabri*, që po kthehej me

¹ Noel MALCOLM, *Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit*, Studime mbi historinë e shqiptarëve, Prishtinë, 2020, fq. 21, 24, 58 v.

²Po aty fq. 59.

anije nga udhëtimi i tij në Tokën e Shenjtë në vitin 1483 përshkruan se si anija nuk ishte në gjendje të vazhdonte lundrimin para Krishtlindjeve për shkak të shkëmbinjve nënujorë në bregdetin shqiptar dhe pse ata nuk ishin në gjendje të shkonin në një port të sigurt në Shqipëri pasi osmanët kishin nën kontroll zonën. Më vonë, kur bashkatdhetari i tij *Johanes Schürpf* nga Lucerni mbërrinë në Korfuz, duke u kthyer nga pelegrinazhi, ai ishte këshillua të shmangte rrugën e drejtpërdrejtë për në Shqipëri, pasi bregdeti ishte i populluar nga osmanët dhe i rrezikshëm.³

Pas 25 vitesh rezistencë kundër Perandorisë Osmane nën udhëheqjen e heroit të famshëm kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, i cili vdiq në vitin 1468, shumë familje shqiptare u larguan në shtetet italiane. Disa prej tyre më vonë u treguan se ishin udhëheqës të talentuar ushtarakë, ushtarë dhe luftuan për Papën dhe republikat e tjera italiane. Gati një shekull më

³ Po aty fq. 68.

vonë, dy familjet e famshme fisnike shqiptare Bruti dhe Bruni⁴ hynë në shërbim të luftës kundër Perandorisë Osmane dhe dhanë një kontribut të rëndësishëm edhe si ndërmjetësues.

Nga fundi i shekullit të 16-të, në vitin 1596, Antonio Bruni, një shqiptar, shkroi një traktat mbi "*Bejlerbejlikun e Rumelisë*". Antonio ishte një përfaqësues i respektuar i familjes fisnike Bruni dhe kishte njohuri të gjera për Perandorinë Osmane, veçanërisht për territoret evropiane dhe shqiptare. Pikëpamja e tij për perandorinë ishte unike, sepse ai e shikonte atë nga këndvështrimi i një intelektualit shqiptar që kishte doktoruar në drejtësi në vitin 1586.⁵ Ky raport apo traktat i Antonio Brunit është jashtëzakonisht interesant sepse ndryshon nga raportet e zakonshme të shkruara nga diplomatët dhe udhëtarët

⁴ Noel MALCOLM, Angjentë perandorak, Një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit gjashtëmbëdhjetë, Tiranë 2016.

⁵ MALCOLM, Angjentë perandorak, fq. 298.

perëndimorë për Perandorinë Osmane të kësaj periudhe.⁶

Në shekullin e 16-të, kardinali Cinzio Aldobrandini dhe rrethi i tij u interesuan për një revoltë të mundshme në Ballkan dhe në viset shqiptare të Perandorisë Osmane. Sekretari i Cinzios, Angelo Ingegrin, ishte informuar se Antonio Bruni kishte njohuri të gjera për këtë temë. Bruni ishte një figurë e rëndësishme, ekspertiza e të cilit për këtë qëllim vlerësohej shumë. Në këtë kohë Brunin e kërkonte edhe Lazaro Soranzo, i cili shkroi librin "*L'Ottomanno*" në vitin 1596 dhe për librin e tij mori nga Antonio informacione të ndryshme për zonat e pushtuara të Evropës nga Perandoria Osmane. Dy traktatet e para të Brunit mbi Perandorinë Osmane dhe Rumelinë, të cilat Soranzo dhe Ingegrin i përdorën dhe ia dërguan kardinalit Cinzio, nuk ekzistojnë më. Ka vetëm dy kopje të mëvonshme të tij nga viti 1598.⁷

⁶⁶ MALCOLM, Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit, fq. 97.

⁷ Noel MALCOLM, Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit, fq. 97 v.

Antonio Bruni, në raportin e tij të asaj kohe, theksoi rrezikun e inkurajimit të shqiptarëve të krishterë për t'u ngritur për një rezistencë të pashpresë. Kjo mund të çojë në humbje edhe më të mëdha, pasi shqiptarët tashmë janë në një situatë të vështirë dhe janë nën presionin e shtuar të Perandorisë Osmane. Pa mbështetje nga jashtë do të jetë shumë e vështirë të ruhet qëndresa e tyre, gjykonte ai.⁸ Kjo përfundimisht mund t'i detyronte ata të pranonin paqen me Perandorinë Osmane në kushte jashtëzakonisht të pafavorshme.⁹ Bruni ishte i vetëdijshëm për rrezikun që përbënin shpresat joreale që ushqeheshin pa ndihmën e jashtme dhe se, sa të rënda mund të ishin pasojat për shqiptarët e krishterë. Në këtë kontekst ai shkruan: "*Unë e di se sunduesit [e krishterë] nuk mund të mashtrohen nëse nuk duan të mashtrohen*".¹⁰ Bruni e kishte fjalën për një nga kryengritjet e

⁸ Po aty, fq. 124

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty, fq. 125.

fundit e nxitur nga premtimet e rreme, e cila kishte një pasojë serioze për shqiptarët e krishterë.

Vlen të theksohet se traktati i Brunit është shkruar rreth 50 vjet pas botimit të veprës së Vadianit "*Epitome*". Prandaj, informacioni i Antonio Brunit mund të jetë një shtesë e vlefshme për rajonet e paraqitura nga Vadian në librin e tij.

Në traktatin e Brunit përshkruhet se Bejlerbejllëku i Rumelisë është i banuar nga popuj të ndryshëm me gjuhë dhe fe të ndryshme. Të krishterët përbëjnë shumicën në krahasim me myslimanët. Për shkak të ndarjes midis të krishterëve ortodoksë dhe katolikë, konkurrencës midis kishave dhe injorancës së shumë prelatëve të krishterë, shumë të krishterë, megjithëse mbajnë emra të krishterë, dinë pak për besimin e tyre. Bruni përshkruan edhe shqiptarët që jetojnë në rajonetë ndryshme si Epiri, Dardania, Maqedonia, Iliria e deri në Peloponez në Greqi.¹¹

¹¹ Traktatin e plotë të Antonio Brunite gjeni te libri i MALCOLM, Rebelët, besimtarët, të mbijetuarit (engl. Rebels, Believers, Survivors), fq. 97-130.

Duhet theksuar se përsa Vadiani e kalonte kohën në Vjenë, ai kishte qasje në informacione bashkëkohore për Evropën Juglindore dhe shqiptarët në veçanti. Kjo ishte për shkak jo vetëm të interesit politik të Vjenës në atë kohë, por edhe të udhëtimeve dhe kontakteve të shumta të Vadianit me personalitete të ndryshme.

Rreth 10 vjet më parë, Albert Ramaj, bashkdrejtues në Albanisches Institut (Institutin Shqiptar),¹² bëri një zbulim interesant se kjo figurë e shquar jo vetëm kishte një ndikim të qëndrueshëm në pamjen e St. Gallenit, por kishte edhe njohje në një nga veprat e tij për rajonet e banuara nga shqiptarë në Evropën Juglindore.

Për këtë arsye, ky studimpërshtatet në kuadrin e kërkimor të Institutit Shqiptar (Albanisches Institut), i cili që në fillim të themelimit ka vënë në fokus të veçantë marrëdhëniet zvicerane-shqiptare.

¹² www.albanisches-institut.ch (St. Gallen, 12. 06. 2020)

Monumenti i Vadian

Kushdo që jeton në St. Gallen (Zvicer) ose e viziton qytetin do të gjejë një statujë mbresëlënëse bronzi në sheshin e tregut (Marktplatz) në St. Gallen, që paraqet një figurë imponuese 3,75 metra të lartë. Kjo statujë është e Joachim von Watt - i njohur më mirë si Vadian. Ai jo vetëm që përdoret sot si një vend takimi dhe vend i njohur për të qëndruar për banorët dhe vizitorët e qytetit, por është gjithashtu i lidhur ngushtë me historinë e St. Gallen-it, siç tregojnë në mënyrë mbresëlënëse Vadianplatz, Biblioteka Kantonale Vadiana St. Gallen.

St. Gallen ka gjithashtu një popullsi të larmishme, duke përfshirë emigrantë dhe emigrante, të cilët shpesh frekuentojnë sheshin përreth Monumentit Vadian. Mes tyre ka edhe shqiptarë të shumtë. Ata nuk dini asgjë për këtë personalitet që ka jetuar dhe punuar në St. Gallen 500 viteve më parë.

Jeta dhe vepra e Vadianit

Përpara se t'i drejtohem pyetjes qendrore të këtij artikulli, është e një rëndësie të madhe që të njihemi me historinë e jetës së Vadianit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi ky artikull do të publikohet në gjermanisht dhe shqip. Në këtë ese unë do të përpiqem të paraqes sfondin dhe kontekstin e pyetjes së ngritur këtu sa më qartë dhe sa më të kuptueshme që të jetë e mundur për lexuesit gjermanishtfolës dhe shqipfolës. Prandaj këtu ka nevojë për përfshirjen e një përmbledhje të biografisë së Vadianit.

Joachim von Watt lindi më 29 nëntor 1484 (ose ndoshta më 1 dhjetor 1483) në një familje tregtare në St. Gallen. Prindërit e tij ishin Lienhard von Watt dhe Magdalena Thalmann. Vadian vdiq më 6 prill 1551.

Ai ndoqi shkollën latine në vendlindjen e tij në St. Gallen. Më pas u regjistrua në Universitetin e Vjenës në semestrin dimëror të vitit 1501/1502 dhe u pranua në regjistrin e fakultetit artistik. Atje

ai studioi te personalitetet të shquara si Konrad Celtis, Johannes Cuspinian dhe Georg Tannstetter. Në vjeshtën e vitit 1508 ai mori gradën akademike të magjistraturës në Vjenë. Nga viti akademik 1511/1512 ai punoi si ligjërues në universitet dhe madje mbajti detyrën e rektorit në vitin akademik 1516-1517. Për më tepër, nga viti 1516 ai ishte profesor i poetikës në *Collegium poetarum*. Në vitin 1514 ai mori detyrën e zëvendëskancelarit të universitetit dhe ishte anëtar i *Consilium facultatis* të paktën në 1515/16. Ai kishte qenë anëtar i *Collegium ducale* që nga viti 1514. Në të njëjtin vit, 1514, ai mbajti, ndër të tjera, një leksion për Pomponius Mela-n. Më 12 mars 1514, ai u kurorëzua poet laureat nga perandori Maksimilian I në Linz. Më në fund, Vadiani përfundoi studimet e tij mjekësore me një doktoraturë në vitin 1517.¹³

¹³ ALBERT SCHIRRMEISTER, Vadian (Vadianus, von Watt), Joachim, në: *Deutscher Humanismus 1480-1520*, Verfasserlexikon, Band 2, L-Z, Berlin 2009, 1178-1238, këtu fq. 1178.

Gjatë studimeve ai ndryshoi emrin në *Vadianus* për të shprehur pasionin e tij për gjuhën latine dhe humanizmin. Prandaj ai shpesh quhet Joachim Vadian. Leksionet e tij në Vjenë rezultuan në botime të ndryshme, veçanërisht botime e komentuara për shkrimtarët antikë, duke përfshirë edhe një botim për gjeografin romak Pomponius Mela në vitin 1518.¹⁴

Në 1518, Vadian mbaroi punën e tij në universitet dhe u kthye në St. Gallen për t'i shërbyer vendlindjes së tij. Pas këtij vendimi, në muajin dhjetor ai bëri udhëtimin të fundit të madh në Evropën Lindore e Qendrore. Ai udhëtoi përmes Leipzig, Posen, Breslau dhe Krakov dhe arriti përsëri në Vjenë pas pothuajse tre muajsh, nga fundi i shkurtit 1519. Prej aty u kthye në St. Gallen në fund të majit 1519. Gjatë epidemisë së murtajes të viteve 1506/1507 ai qëndroi në Villach, ku punoi si mësues dhe prej andej bëri udhëtimin e

¹⁴ Joachim Vadian, Historisches Lektin der Schweiz, <https://hls-dhs-dss.ch/de/articles/012383/2013-11-19/> (16. 10. 2021).

tij të parë në Itali. Gjatë këtij udhëtimi ai vizitoi qytete si Venecia, Trieste, Udine dhe Padova, ku u takua me Mauritius Hybernicus.¹⁵

Trashëgimia e Vadianit

Shumica e librave të shtypur të Vadianit janë të kohës kur ai studioi në Vjenë. Gjatë jetës së tij, shumë nga shkrimet e tij nga koha e tij në St. Gallen mbetën të pabotuara dhe shpesh ato nuk ishin të destinuara për publikim.¹⁶ Ai ishte humanist, doktor dhe studiues, si dhe kryetar bashkie dhe reformator në qytetin e St. Gallenit. Ai la pas një trashëgimi të larmishme dhe të pasur. Veprat e tij përfshijnë poezi,¹⁷ fjalime,¹⁸ historiografi,¹⁹ gjeografi,²⁰ teologji,²¹ mjekësi²² dhe letra.²³

¹⁵SCHIRRMEISTER, Vadian... fq. 1178-1179.

¹⁶Po aty, fq. 1185.

¹⁷Po aty, fq. 1186 v.

¹⁸Po aty, fq. 1197 v.

¹⁹Po aty, fq. 1200 v.

²⁰Po aty, fq. 1206 v.

²¹Po aty, fq. 1212 v.

²²Po aty, fq. 1217 v.

²³Po aty, fq. 1228 v.

Gjatë kohës së tij në Vjenë, Vadian shkroi kryesisht vepra poetike, botime shkencore dhe fjalime. Këto tekste ishin shkruar në latinisht dhe kishin kontekstin e tyre social në pallat dhe në universitet.

Në St. Gallen, megjithatë, Vadian shkroi shkrime teologjike dhe historiografie, shumica e të cilave ishin në gjermanisht. Megjithatë, një pikë interesante është se interesimi i tij për temat gjeografike (humane) që i vazhdoi në të dyja periudhat. Kjo ishte e dukshme edhe në faktin se ai përfshinte këndvështrime gjeografike në reflektime e tija të temave teologjike. Ky aspekt gjeografik gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në këtë ese. Këtu bëhet fjalë për atë që në kohën e Vadianit quhej "*gjeografia biblike*". Si pjesë e kësaj perspektive gjeografike, Vadian u mor me gjeografinë biblike, e cila është një formë e hershme e gjeografisë historike dhe studimit të marrëdhënieve midis fesë dhe hapësirës, e njohur edhe si gjeografi fetare. Kjo disiplinë u zhvillua në

shekujt XVI dhe XVII dhe merrej me gjeografinë biblike dhe kohën e përshkruar në Bibël.

Në thelb, gjeografia biblike hulumtonte vendet e përmendura në Bibël dhe përshkruante territoret dhe vendet që shfaqen në shkrimet e shenjta në aspektin fizik dhe politik. Vepra e Vadianit "*Epitome trium terrae partium*" është një shembull i këtij lloji kërkimi dhe eksplorimi. Në thelb, gjeografia biblike ekzaminoi vendet e përmendura në Bibël dhe përshkroi territoret dhe vendet që shfaqen në shkrimet e shenjta në aspektin fizik dhe politik. Vepra e Vadianit "*Epitome trium terrae partium*" është një shembull i këtij lloji kërkimi dhe eksplorimi.

Epitome trium terrae partium

Botimet e Vadianit nuk ishin aq të suksesshme në asnjë fushë sa në gjeografi. Pas një pauze prej dhjetë vjetësh, ai u kthye në studimet e tij humaniste në vitin 1532 dhe që atëherë iu përkushtua Kishës së Reformuar. Në fushën e

gjeografisë, ai vazhdoi punën e tij të mëparshme dhe botoi "*Epitome trium terrae partium*", një përshkrim i botës që ishte i përshtatshëm edhe për studimin e Biblës, siç tregon qartë titulli i librit.²⁴ Kjo vepër u shkrua dhe u botua në latinisht. Është interesante se, sot ka vetëm disa studime të pakta mbi veprën "*Epitome...* ".²⁵

Libri "*Epitome*" lindi nga leksionet në St. Gallen dhe shërbeu si një përmbledhje në leksionet e tij mbi Veprat e Apostujve. Ai iu referua leksioneve të tij të mëparshme në Vjenë. Ky libër u krijua për të mbështetur të kuptuarit e Tokës së Shenjtë dhe rrjedhimisht studimin e Biblës. Ai ofron një paraqitje të strukturuar të gjeografisë, duke marrë parasysh autorët antikë dhe bashkëkohorë të kohës, duke përfshirë gjeografët e Shkollës së Vjenës. Lidhur me formën e Tokës, Vadian mbulon tema të ndryshme si erërat, zonat e Tokës, kontinentet dhe ndarja e Tokës në oqeane

²⁴Po aty.

²⁵Po aty.

dhe toka. Ai jep përkufizime për ishujt, kontinentet dhe jep një tipologji të qyteteve. Ai ofron edhe përshkrime historiko-gjeografike të botës së njohur, me fokus Evropën. Diskutohen aspekte të tilla si Galia, Pirenejtë si kufi me Hispaninë, provincat romake, pjelloria e tokës, trimëria e Galëve, qytetet, Helvetikët dhe themelimin e qyteteve antike. Vepra përmban gjithashtu një përshkrim të Germania-s, bazuar në veprat e Cezarit dhe Tacitit.²⁶

Në pranverën e vitit 1533, me sugjerimin e Heinrich Bullinger, Vadian filloi të punonte për një vepër të re gjeografike. Njohja midis Bullingerit dhe Vadianit ishte zhvilluar në tetor 1531, kur Bullinger u zgjodh kryetar i kishës reformatore në Cyrih. Një vit më pas, Bullinger kërkoi këshillën e Vadianit për çështje fetare dhe politike dhe Vadiani e ndihmoi me dëshirë.²⁷

²⁶SCHIRRMEISTER, Vadian, fq. 1210.

²⁷GAMPER, Joachim Vadian, fq. 269.

Në 1533, Bullinger planifikoi të përgatiste një koment mbi Veprat e Apostujve dhe kontaktoi Vadianin rreth mesit të vitit. Ai ishte shumë i interesuar që Vadiani të kontribuonte në një trajtim gjeografik të titulluar "*Epitome trium terre habitate partium*" për këtë komentim, i cili në fakt ishte pjesë e leksionit (ligjëratave) të tij mbi Veprat e Apostujve. Vadiani kishte rreth një muaj për të rishikuar pak tekstin dhe për të shtuar komentin e tij përpara se ai të përgatitej për shtyp. Fatkeqësisht, projekti nuk ishte i suksesshëm, sepse Christoph Froschauer që e kishte shtypshkronjën, e vlerësoi tekstin e dhënë nga Vadian të ishte shumë i varfër. Prandaj, komenti i Bullinger-it mbi Veprat e Apostujve u publikua në gusht 1533 pa punimin gjeografik të Vadianit.²⁸

Megjithatë, Bullinger vazhdoi ta inkurajonte Vadianin të punonte në punën e tij gjeografike, pasi mendonte se kishte një kërkesë të madhe për këtë temë. Vadian vendosi ta vazhdonte

²⁸Po aty, fq. 264.

projektin si një vepër më vete, me titullin paksa të përshtatur dhe më të shkurtër se ai i leksionit origjinal.²⁹

Në këtë vepër, Vadiani frymëzohet shumë nga gjeografët e lashtë romakë. Ai përdori idetë e tyre dhe shpesh i vendosi në një kontekst historik. Si rezultat, ai ka ndjekur ndryshimet që nga koha romake. Në përshkrimet e tij për vendet, ai i jep rëndësi të barabartë gjeografisë dhe historisë.

Vadiani e pa Biblën si një tregim historik në përputhje me njohuritë shkencore të kohës së tij.³⁰ Kjo përputhje mirë me interpretimin e mirëfilltë të Biblës të ndjekur nga Bullinger dhe eksegetët reformator në Cyrih. Ai gjithashtu besonte se do t'i shërbente besimit nëse mësuesit e Shkrimit të Shenjt dhe udhëheqësit e kishës do të merreshin gjithashtu edhe me njohuritë laike.

Në fund të një letre të gjatë që ia kushton veprës, Vadiani flet se si gjeografia e tij mund të

²⁹Po aty, fq. 264.

³⁰Po aty, fq. 265 v.

ndihmojë në kuptimin e Biblës. Ai thekson se njohuritë gjeografike dhe njohja e vendeve janë parakushte të rëndësishme për të kuptuar Shkrimin e Shenjt. Libri "Epitome" u botua nga Christoph Froschauer, shtypshkronjë në Cyrih. Rreth një mijë kopje u shitën në Panairin e Librit të Frankfurtit në vjeshtën e vitit 1534.³¹ Botimi i parë i vitit 1534 përmend se ka harta, por ato nuk janë përfshirë në botim.³²

Katërmëdhjetë vjet më vonë, në 1548, "Epitome" u botua në një botim të dytë.³³ Ky botim përmbante disa përmirësime, por jo të gjitha ishin nga vetë Vadiani, disa ndryshime u bënë në letrën kushtuese dhe u shtuan grafika shtesë dhe një hartë botërore e vitit 1546. Veçanërisht të rëndësishme se ky botim pasurohet me hartat e vendeve dhe rajoneve individuale, të cilat Vadiani i kishte kërkuar t'i bashkëngjiteshin edhe botimit

³¹Po aty, fq. 66.

³²(Zürich: Chr. Froschauer, Sept. 1534.)

³³ J. Vadian, Epitome trium terrae partium, Zürich, Chr. Froschauer, 1548.

të parë e nuk ishte bërë. Shtypshkronja e Cyrihut e Christoph Froschauer-it shtoi një hartë botërore në ribotimin e "Epitome". Vadian kishte përdorur tashmë harta gjatë leksioneve (ligjëratave) të tij në Vjenë për t'u dhënë studentëve të tij një kuptim më të mirë të gjeografisë së tokës. Që atëherë ai kishte mbrojtur dhe promovuar përdorimin e hartave në gjeografi.³⁴

Një version i mëparshëm i "Epitome" të Vadianit, i cili gjithashtu ka lidhje me shkollën e Pomponius Mela, është përfshirë në një antologji të përpiluar në 1519 me tekste leksionesh gjeografike nga Vjena. Në fillim, ky version ndryshon dukshëm nga "Epitome" e mëvonshme.³⁵ Megjithatë, kapitujt e mëposhtëm, secili prej 1-8 faqesh, tregojnë ngjashmëri me veprën e shtypur

³⁴GAMPER, Joachim Vadian, fq. 267.

³⁵ Nach A. Schirrmeister, Zürich, Zentralbibl. (Druckschriften), Ry 318, Teil VII, Bl. 2'-385: Joachimus Vadianus Introductorium sive Epithoma in geographiam et terre descriptionem. SCHIRRMEISTER, Vadian, fq. 1211.

të mëvonshme. Madje kemi disa formulime të njëjta, por ato janë të renditura ndryshe.³⁶

Evropa Juglindore në Epitome

Siç u përmend tashmë, në leksionet e tij në Vjenë, Vadian foli kryesisht për veprat e autorëve antikë, duke përfshirë gjeografin romak Pomponius Mela. Mela ishte një gjeograf i lashtë romak që jetoj gjatë Perandorisë së hershme Romake, veçanërisht në vitet 43–44 pas Krishtit. Gjatë kësaj kohe, ai shkroi një traktat mbi gjeografinë botërore të njohur në atë kohë.³⁷ Vadian iu përkushtua gjerësisht paraqitjes së rregullt të gjeografisë biblike, duke studiuar veprat e autorëve të lashtë dhe bashkëkohorë të kohës, veçanërisht të gjeografëve të Shkollës së Vjenës. Në shkrimet e tij ai dha përshkrime historiko-gjeografike të vendeve të botës së atëhershme të njohur, me fokus të veçantë

³⁶SCHIRRMEISTER, Vadian, fq. 1211-1212.

³⁷Krhs. Wikipedia. https://de.wikipedia.org/wiki/Pomponius_Mela.

në Evropë. Megjithatë, vlen të theksohet edhe se ai është marrë edhe me përshkrimin e Evropës së sotme juglindore, duke përdorur si udhërrëfyes ndarjen e zonave në bazë të provincave romake të lashtësisë.³⁸ Ai u përqendrua në zonat dhe rajonet që kishin një rëndësi të veçantë, duke përfshirë *Panonia Prima* dhe *Panonia secunda*,³⁹ *Moesia Superior*, *Moesia Inferior*, *Thracia*, *Macedonia*, *Epiri*, *Iliri*, *Liburnia* dhe *Istria*.

Në këtë vepër, Vadian trajton si Shqipërinë historike Kaukaziane,⁴⁰ e cila nuk shfaqet në hartat e përfshira në botimin e dytë, ashtu edhe Shqipërinë e sotme. Hartat e përfshira në botimin e dytë tregojnë territorin aktual shqiptar dhe në përshkrimet e tij të mëtejshme, sidomos kur flet për rajonin e Dalmacisë, i referohet edhe

³⁸Krhs. si orientim hartën me ngjyra e dhënë në fund.

³⁹J. Vadian, *Epitome trium terrae partium*, Zürich, Chr. Froschauer. Unë do t'i shënoj në vijim faqet e botimit të parë nga viti 1534 me a dhe numrin e faqes, ato të botimit të dytë të vitit 1548 me b dhe numrat e faqeve. : a fq. 62 dhe 65, b. fq. 81. Dhe fq. 84.

⁴⁰Po aty. a fq. 406, b fq. 376.

Shqipërisë.⁴¹ Duke vepruar kështu, ai shton se "*i gjithë rajoni tani quhet Shqipëria, siç dihet nga të dhënat e Ptolemeut dhe Plinit në lidhje me Maqedoninë*".⁴²

Përveç Shqipërisë, ku ka një mospërputhje midis tekstit dhe hartës, hartat ilustrojnë karakteristikat gjeografike të rajoneve të përshkruara nga Vadian dhe tregojnë vendet dhe qytetet në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin. Këto harta ishin një shtesë e rëndësishme për përshkrimet e Vadianit, pasi u dhanë lexuesve të tij një ide vizuale të veçorive gjeografike dhe rregullimit hapësinor të vendeve dhe qyteteve. Ato ndihmuan për të sqaruar informacionin në veprën e Vadianit dhe për ta bërë më të lehtë për t'u kuptuar nga lexuesit.

Për të dhënë një ilustrim më të mirë, ne këtu në shqip,⁴³ do të përmbledhim pjesë të përshkrimeve të Vadianit për rajonet e Evropës Juglindore të

⁴¹Po aty a fq. 91 f. dhe b. fq. 110 v.

⁴²Krhs. këtu pjesën që flet për Dalmacinë.

⁴³Këto pjesë janë të përkthyer nga prof. Oliver Sedaj.

shkruara në latinisht. Fokusi këtu nuk është në kontrollimin e saktësisë së fakteve dhe përshkrimeve që ai përdori, por më tepër atë se si ai i përcolli ato. Në këto tekste ndër të tjera përmendet edhe Shën Pali apostull, i cili luan një rol në historinë e përhapjes së krishterimit në këtë pjesë të Evropës dhe te shqiptarët.

***a) Moesia Superior (Mezia e Epërme)*⁴⁴**

Mezia fillon aty ku bashkohet Danubi me Savën, me malet maqedonase në jug dhe me Ortuamne Ciabro sipas të dhënave të Ptolemeut. Është fjala për një fushë shumë pjellore të ujitur nga lumi më i famshëm i Dardanisë, Bosnja e sotme e quajtur Serbi dhe Rashkën. Por pasuria e krahinës ishte mjaft e madhe, sepse rezulton pikërisht kjo se kujtimi i etërve tanë iu shfaq mbretërve që vranë në emër të saj. Sot mbretëria e Bosnjës është e zbrazët.

⁴⁴ J. Vadian, *Epitome trium terrae partium...* a fq. 89; b fq. 70.

Qytetet e Mezisëishin të shumta, por prej tyre më i famshmi ishte qyteti në Hungari Sinderonia (Dardanu), por nuk janë edhe aq afër mbretërve të Bosnjes, por ata të turqve. Ata bënë shtëpitë e tyre në Mezi. Në Savë dhe Danub shumë e qartë ishte Amnisi, në bashkimin e Taurusit, ku është vendosur tani, të cilin e ka vendosur në Panoni Plini i cili e quan Beogradin Alba dhe Greaca, një qytet emri është më i famshëm për madhësinë e tij, po dhe jo aq shumë për hendeqet apo muret që e rrethojnë ky vend është me lumenjtë, në kodrat, që kërcënojnë, një kështjellë shumë të fortifikuar, në perëndimin e diellit dhe Boreas. Kurse nën veshin e këndshëm të Boreas të gjerë si shikues dhe më poshtë është një fushë e këndshme dhe shumë e fuqishme, nga e cila vetëm nga ana tjetër, meqenëse i përmbahet kontinentit si toka, është i hapur ndaj rrethimit, që në fakt atë u përpoqën edhe një herë të sulmonin turqit me një numër të madh të njerëzve të saj e që u zbrapsen me disfatë. Në fund, në vjeshtën e vitit 1521, Vladislavi

ishte ende gjallë dhe mbreti, babai i tij Ludvigu, i cili kohët e fundit e pësoj në një betejë fatkeqe, ku Selinusi u rrethua nga turqit dhe u shkatërrua, ndërsa toka u godit me ushtri të mëdha Perandori i turqve sulmonte por disa prej kështjellave nuk ishin shumë të fortadhe larg nga Tauruni, në brigjet e Savës dhe Danubit, të vendosura në të njëjtën luftë me garnizonet dhe forcat e tij shtriheshin dhe morën goditje të përgjithshme (e të dhimbshme). Ky është Taurunumi, Hungarezët dikur shërbenin me veprat të mrekullueshmetë Jon Kapistrani, prandaj midis françeskanëve ato nderime u dekretuan pothuajse si triumfale. Hyra te Huniadi i lëvdur, një burrë fisnik dhe i madh, i cili erdhi në Kapistrannë të njëjtën kohë u tregua se lavdia e këtij qyteti të pushtuar i takonte vetëm atij.

b) Moesia Inferior (Mezia e Poshtme)⁴⁵

Moesia Inferior, e njohur gjithashtu si "Moesia e Poshtme", shtrihet nga majat më të larta të maleve

⁴⁵Po aty. a fq. 90; b fq. 72.

Haemus dhe ngushtohet në një zonë të ngushtë. Nga fisi i Tribalëve të lashtë, më të shumët dhe në gjendje superiore ishin Dardanët, nga të cilët Dardania quhej edhe si Mezia e Epërme. Kjo tokë ujitej nga lumenjtë pjesërisht në Istër e pjesërisht në Euksinë. Euxine papritmas përkulet drejt Borea-s dhe së shpejti drejt perëndimit dhe më në fund përkulet me vështirësi dhe merr Ieasus-in, i cili është zbritur nga malet e Getisit, por, pasi ka hyrë në masën e madhe të valëve, jomë gjatë duke mbajtur pamjen e një lumi, por më tepër të një liqeni, gjashtë lumenjtë që derdhën në Pont të cilin edhe e vërshojnë.

Plini na jep të dhënat për detajet ku bregdeti është aq i madh sa mund të matet me dyzet milje. Në bashkimin e detit e kam kuptuar pikën më të ëmbël. Është padyshim kjo e fundit. Nili është më i madhi lum nga të gjithë përbërësit mesdhetar. Tani kjo quhet, nga ku Plini aludoi për herë të parë për Ilirikun, domethënë ku bashkohet Sava kurse sot i gjithë rajoni e ka emrin e Bullgarisë të cilën e

sundoi, i fundit prej të cilëve ishte Markus Kraiekvikus, i cili Bajaziti e mundi dhe vrau pushtuesi turk dhe pushtoi pjesën më të madhe të tokës së tij. Pas së cilës e tëra iu dorëzua turqve. Në Bullgari ishte peshkopi Theophilaktus, meemrin e tij Vulgarius. Gjithashtu, Theotimus Tomari i lashtë, të cilin Gjirolamoe përmend në Librin e Burrave të famshëm. Aty ndodhen edhe Tomas, një qytet detar në të cilin u strehua poeti Ovidius, jo shumë larg Istropolisit, qyteti më i famshëm...

c) Thracia (Trakia)⁴⁶

Gaj Plini, në librin 4, përshkruan shtrirjen e Euksines nga portat e Istrisë e cila shtrihet në jug, të cilat ia atribuon Thrakisë, si në librin 3të të Melas. Ndërsa Ptolemeu në jug duke ndjekur një plan të caktuar, e ndan plotësisht Mezinë nga Trakia. Më tutje mund të vazhdojmë me rrëfimin e nisur më qartë, Ptolemeu, i cili vijon, muri që e

⁴⁶Po aty. a fq. 92; b fq. 73.

kufizon Trakinë nga veriu i maleve Hemi e deri në vargmalet më të larta, nga Orti në anën e Euksine dhe Bosforit, prej andej në brigjet e Propontis dhe Kersonese njihen si Traki, nga mjedisi dimëror i Nessi,(si Pomponi që e quan) në foletë e lumenjve dhe maleve të grykë derdhjes, duke u larguar nga Orbelusi, kullotat dhe përfundon me detin Egje.

